

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

83H-2  
A 58

TASIM  
ALIAJ



***UDHIËT  
E HEKURTA***

PJESE  
TEATRALE

*814-2*

*A 58*

TASIM ALIAJ

# UDHËT E HEKURTA

(Pjesë teatrale)



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1500 kopje

Format 70 x 100/32

Stash: 2204-72

---

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1976

**PERSONAT:**

*VASOJA, PIONIER*

*KOÇOJA,*      "

*LAZJA,*      "

*PANDI, VËLLAI I VASOS*

*NIKOJA, BABAI I VASOS*

*DRITA*

*FATMIRI*

*LIPJA*

*SHYQYRIU*

*SABOTATORI I*

*SABOTATORI II*

*VULLNETARE, VULLNETARE*

— Ngjarja zhvillohet në një nga hekurudhat tona të para.

## TABLLOJA E PARË

Në hekurudhë. Një barakë. Në hyrje të saj shkruhet: «KOMANDA E SHTABIT TË HEKURUDHËS». Më tutje një tabelë tjetër me mbishkrimin «MENSA». Duken stola të gjatë. Kalojnë vullnetarë me kazma, lopata dhe karroca dore. Kur hapet perdja, në një qoshe të skenës është mbështetur Lazja, një pionier. Ai rri i menduar.

LAZJA: — (Thërret) O shoku vullnetar! (Nuk i përgjigjet njeri. I thërret një tjetri.) Shoko, o shoko... (Në këtë kohë hyjnë Vasoja dhe Koçoja).

VASOJA: — Ja, këtu ndërtohet hekurudha. E shikon, Koço?

KOÇOJA: — E shikoj, e shikoj. Hajde, hajde, ç'paska këtu! Gurë, zhavorr, gërmime, lopata... Kështu na qenka hekurudha?

VASOJA: — E pse, çfarë prisje ti? (Afrohen dhe vënë re Lazen) Po ti, pse rri këtu?

LAZJA: — Ç'të duhet ty?

VASOJA: — Desha të them, pse rri këtu përjashta?

LAZJA: — Nuk më lënë të futem.

KOÇOJA: — Po përsë ke ardhur?

LAZJA: — Vullnetar!

VASOJA: — (I ndaritin sytë) Vërtet? Edhe unë me Koçon...

LAZJA: — Nga jeni ju?

VASOJA: — Nga Fieri, po ti?

LAZJA: — Elbasanas...

KOÇOJA: — Të la babai?

LAZJA: — (*Tund kokēn*) Në fillim nuk deshi, meqë jam i vogël, po pastaj iu mbush mendja.

KOÇOJA: — Paske baba të mirë.

VASOJA: — Edhe ne të mirë i kemi, edhe nënët edhe baballarët.

LAZJA: — Nuk e di a do të na pranojnë, se... (*Vasos*)  
Sa vjeç je ti?

VASOJA: — Katërmëdhjetë. Edhe Koçoja aq është.

LAZJA: — Unë jam pesëmbëdhjetë dhe nuk më lënë!

KOÇOJA: — (*Vasos*) E, a nuk të thashë?

LAZJA: — Kam një gjysmë ore që rri këtu. E di sa turp më vjen të kthehem në shtëpi? Po unë s'kam për të bërë këmbë...

VASOJA: — As ne nuk shkulemi që këtej, jo!

KOÇOJA: — (*Lazes*) Po ç'punë do të bëjmë po na pranuan, si thua ti? Se s'ta di as emrin...

LAZJA: — Laze më quajnë... Ç'punë? Ku ta dish! Këtu punojnë me lloj-lloj veglash. Edhe dinamit përdorin, se çajnë shkëmbinjtë. Demek mina.

KOÇOJA: — Jo, ore (*Vështron Vason*).

VASOJA: — Mos fol ashtu, Laze, se na trembe Koçon. (*Lazja qesh*).

KOÇOJA: — Nuk kam frikë unë, jo, po pyeta ashtu, kot. Vaso, lëri shkatë, se të del keq pastaj...

VASOJA: — Po futem unë njëherë këtu, ju hajdeni pas meje (*Kalon një vullnetar me të shpejtë*.) O shok, dua të pyes...

VULLNETARI: — Më fal, po kam një punë tepër të ngutshme (*Kalon*).

LAZJA: — E pe? Nuk ta var njeri këtu, jo... (*Kalon një vullnetar me vare në sup*).

KOÇOJA: — Kanë punë njerëzit këtu, s'janë si ne...

VASOJA: — Shok... E di ti se kush është këtu i madhi i hekurudhës?

VULLNETARI: — Këtu ka shumë të mëdhenj! (*Qesh*)  
Të vegjlit na mungojnë...

VASOJA: — Po ai, si i thonë, më i madhi fare...

VULLNETARI: — Mos doni komandantin e shtabit?

LAZJA: — Hë, atë duam!

VULLNETARI — (*Tregon me dorë*) Ja ku e ka zyrën,  
atje! Apo s'dini të lexoni? (*Qesh*).

VASOJA: — Si, ore, s'dimë! Po thamë...

KOÇOJA: — Na lënë të hyjmë?

VULLNETARI: — Ju lënë, pos! Dale, pritni këtu. (*Futet në zyrën e komandantit dhe pas pak del bashkë me të*) Ja, këta!

KOMANDANTI: — (*U afrohet*) Hë, po ju? (*Pauzë*)

VASOJA: — (*Vështron shokët, asnjeri nuk flet*) Ne,  
unë... dua të them, ky Koçoja dhe unë jemi vërsnikë... Lazja është vetëm një vit më i madh, po edhe ky është i shkurtër sa ne...

LAZJA: — Kush është i shkurtër, unë?

KOMANDANTI: — Mirë, ju shoh, po ç'punë keni?

LAZJA: — Ne erdhëm vullnetarë, të punojmë këtu...

KOMANDANTI: — (*Qesh, ata shihen sy në sy*) Si the?  
(*Qesh prapë*).

VASOJA: — (*I fyer*) Këtu nuk ka gjë për të qeshur...  
Na thuaj, më mirë, ikni!

LAZJA: — Mësuesi në shkollë na ka thënë gjithnjë:  
«Është nder i madh të shkosh në hekurudhë»...  
kurse ju qeshni.

KOÇOJA: — Edhe neve... Nuk na ka thënë, Vaso?

VASOJA: — Ore komandant, kështu i pritni miqtë ju  
këtej?

KOMANDANTI: — (*Përkëdhel Koçon*) Mësuesi mirë ju

ka thënë, po ju jeni tē vegjël. E dini ju ç'punë bëhet këtu?

VASOJA: — E dimë, se kot nuk erdhëm. Punojmë ne...

KOÇOJA: — Ç'të punuar se! Ja, do ta shikon...

KOMANDANTI: — (Qesh) Oj, ç'më kënaqët! Qenkeni tē lezetshëm fort. Nga jeni?

LAZJA: Unë jam nga Elbasani.

VASOJA: — Ne nga fshatrat e Fierit. Do tē na pranoni?

KOÇOJA: — Fundja, tē rrimë ca ditë, po nuk punuam, na përzini...

KOMANDANTI: — Dëgjoni, sikur tē ishit pak më tē rritur, me gjithë qejf... Po shkollën e keni lënë?

VASOJA: — Jo, pse ta linim? Ne mbaruam uniken.\*)

KOÇOJA: — Kemi një javë që e mbaruam (*Lazes*) Po ti?

LAZJA: — Edhe unë. Po nuk besuat, e kam në xhep dëftesën (*E nxjerr*) Ja.

KOMANDANTI: — (I merr dëftesën) Të gjitha pesa\*\*) Ju lumtë! Keni ngrënë bukë?

LAZJA: — Jo!

KOMANDANTI: — Mirë, tani do tē hani, do tē çlodheni ca dhe pastaj, pasdreke, do t'ju kthejmë me ndonjë makinë në shtëpitë tuaja. Kështu?

VASOJA: — (Me zemërim) Ikim vetë, pa makinë, ashtu siç erdhëm! (*Zë Koçon nga dora*).

KOÇOJA: — (Vasos) Pse nuk i thua Pandit?

KOMANDANTI: — Kot zemëroheni. Unë dua, po është urdhër.

LAZJA: — Të duash ti, na mban, po nuk do vetë.

KOÇOJA: — Pérderisa je komandant, po tē duash...

---

\*) Shtatëvjeçaren.

\*\*) Në sistemin e mëparshëm tē notave, pesa ishte nota më e lartë.

VASOJA: — (*Ndërpret Koçon*) Unë kam edhe vëllanë këtu... E njeh?

KOMANDANTI: — Të gjithë vullnetarët nuk i njoh dot, se janë shumë. Kanë ardhur nga gjithë Shqipëria.

VASOJA: — Pandi e quajnë.

KOMANDANTI: — (*I gëzuar*) Pse, vëllai i Pandit je ti?

KOÇOJA: — Po, po, i vëllai është, pyete po deshe.

KOMANDANTI: — Si t'ia bëjmë? (*Mendohet*).

LAZJA: — Meqenëse erdhëm... s'ka lezet të na ktheni.

VASOJA: — Mos na e prish, po deshe! Ty të shkon fjala këtu.

KOÇOJA: — Çfarë, more, i shkon fjala? Po ai është komandanti, më i madhi.

KOMANDANTI: — (*Gati me vete*) Po nuk e keni moshën more. Jeni ende pionierë.

VASOJA: — E pastaj? Ç'të keqe paska? Unë nuk e marr vesh këtë punë. Pionierë ka pasur edhe në çetat partizane, kurse ti nuk na pranon në hekurudhë. Ama, komendant...

KOMANDANTI: — (*Me të qeshur*) Or po kështu si e keni zënë ju, më duket se... Hej, ç'më polli (*Thërrët*) Lipeee! (*Pauzë*) O Lipe!

KUZHINIERI: — (*Duke dalë*) Urdhëroni! (*Shikon pionierët*) Po këta mysafirë kolopuça?

VASOJA: — Ne nuk jemi nga ata që thua ti, jemi vullnetarë.

KOMANDANTI: — Jepu të hanë, pastaj shohim e bëjmë... Uluni te ato stolat (*Futet në zyrë*).

KUZHINIERI: — Hë, ç'më shikoni ashtu, nuk ju pëlqej?

LAZJA: — Si qenke nxirë aq shumë me tenxhere! (*Fëmijët qeshin*).

KUZHINIERI: — Ehu, keni nge ju, unë kam kazanët në zjarr. Doni t'ju jap nga një pjatë fasule?

LAZJA: — Duam (*Ulen te stolat e gjatë*. *Hyjnë disa*

vullnetarë. Në mes të tyre edhe Drita. Zhurmë, të qeshura).

DRITA: — (Disave) Brigada e Fierit është zotuar që, gjersa të përfundojë hekurudha, të mos e lëshojë flamurin.

VULLNETARI: — Do të shohim, shoqja Drita. Ne të tjerët nuk jemi zotuar të hamë bar.

DRITA: — (Shikon fëmijët) Ju bëftë mirë! Kur keni ardhur këtu?

VASOJA: — Sot. Sa të hamë drekë, do të fillojmë punën.

DRITA: — (Buzagaz.) Ashtu? (E puth në faqe dhe largohet. Vasoja fshin faqen).

LAZJA: — Pse të puthi ajo çupa ty, e ke gjë?

VASOJA: — Nuk e njoh fare. Oj, kjo! Vjen dhe pllaq, sikur të ka djalin e tetos.

KUZHINIERI: — Hani bukë shpejt, çuna, që të më ndihmoni. Do të qëroni patate, hajde...

LAZJA: — Ne s'kemi ardhur këtu të qërojmë patate.

KUZHINIERI: — Mbylle, ore, ti! Apo doni t'i them komandantit t'ju kthejë nga erdhët? Do të zbatoni urdhrat këtu. Morët vesh, morëm, thuaj! (Hyn Pandi).

PANDI: — Ç'ke, o Lipe, pse grindesh?

VASOJA: — (Sa e sheh, i hidhet në qafë) Pandeli!

PANDI: — (Shumë i habitur) Po ti, mor i pagjalpë, si erdhe gjer këtu, ë? Pa shiko, qenke me shokë... Të mori malli, ë? (Takon Lazen dhe Koçon).

VASOJA: — Po...

PANDI: — Babai, nëna si janë?

VASOJA: — Mirë të gjithë...

LAZJA: — Ne na tha komandanti të punojmë këtu.

KOÇOJA: — Mos gënje. Ende nuk e ka ndarë mendjen.

KUZHINIERI: — (U jep Lazes dhe Koços enë për t'i mbushur me ujë). Ja tek e keni çesmën. Shpejt, se

vijnë vullnetarët. Erdhët, erdhëm, thuaj! (*Ata marrin enët dhe dalin*).

DRITA: — (*Duke hyrë*) Pandi, mbledhja e organizatës bëhet sot pasdite.

PANDI: — E di. E njeh këtë pionerin, Drita?

DRITA: — (*Buzagaz*) E takova.

PANDI: — Është vëllai im i vogël.

DRITA: — (*Me gëzim*) Vërtet? (*E përqafon*) Të keqen motra! Rri këtu sonte me ne. Si të quajnë?

VASOJA: — Unë do të rri gjersa të mbarojë hekurudha. Do të punoj tok me Pandin.

DRITA: — Shumë mirë! Qëndro. Ku i ke ata shokët?

VASOJA: — Ata filluan nga puna (*Hyjnë Lazja dhe Koçoja me gjyma të mbushur*) Ja! (*Thërret*) Shoku kuzhinier!

KUZHINIERI: — Erdhët! (*Del dhe u merr gjymat*) Ashtu, de! Këtu rrötull qëndroni, se kemi punë. Morët vesh, morëm, thuaj.

VASOJA: — Aman, Pandi, foli një çikë këtij kuzhinierit, se kërkon të na mbajë këtu, në mensë.

LAZJA: — Unë kthehem në shtëpi. S'kam ardhur për të qëruar patate (*Pandi dhe Drita qeshin*).

PANDI: — Edhe kuzhina ka punë.

KOÇOJA: — Ne na gjeti ai, s'ka të tjerë?

DRITA: — Puna kudo është nder, kudo njëlloj, si në kuzhinë, si në trase.

KOMANDANTI: — (*Pandit*) Hë, u takuat? Të tha se ç'mendon?

DRITA: — Le t'i mbajmë të tre, shoku Fatmir.

KOMANDANTI: — Kaq shpejt e pretë, shoqja Drita?

PANDI: — Po në shtëpi, mor Vaso, dinë gjë?

VASOJA: — U lashë një letër. Pse, budalla jam unë?

DRITA: — Hë, të kanë faj?

KOMANDANTI: — Epo, le të qëndrojnë, në mos...

VASOJA: — Faleminderit shumë! (*Lazja përqafon Koçon, të tre hidhen nga gëzimi*).

KOMANDANTI: — Pandi, vjen pak në zyrë të diskutojmë çështjen e dinamitit?

PANDI: — Po! (*Futen në zyrë*).

LAZJA: — (*Vasos*) Paska dalë tri herë sulmues yt vëlla, Vaso! Po ti, do të dalësh?

VASOJA: — Po dole ti, do dal edhe unë. (*Qeshin*).

KUZHINIERI: — Hajdeni, çuna, rregulloni stolat, shpejt. Dëgjuat, dëgjuam, thuaj.

KOÇOJA: — Nuk na la rehat ky njeri. Ky qenka njeriu më i rreptë këtu? (*Drita qesh*).

DRITA: — Hajde, i rregullojmë bashkë (*Nisin të punojnë. Nga larg dëgjohet një melodi me fizarmonikë*).

VASOJA: — Paska edhe muzikë këtu?

DRITA: — Hekurudha është shkollë për të gjithë vullnetarët, Vaso. Do të shikoni se sa bukur kalohet.

LAZJA: — Ku do të punojmë ne?

DRITA: — Në brigadën time. Ju pëlqen?

KOÇOJA: — Po. Unë sa do të të lutesha për këtë.

DRITA: — Mirë. Tani ejani pas meje që të flini, se jeni lodhur.

VASOJA: — Shoqja Drita, mos na ndani... (*Hedh tras-tën në sup*).

DRITA: — Jo, bashkë do t'ju vë të flini.

LAZJA: — Rroftë komandantja jonë! Urra! (*Kërcejnë dhe rrrotullohen me Koçon. Drita, në mes tyre, u hedh duart në krahë dhe dalin. Melodia me fizarmonikë vjen duke u shtuar*).

## TABLOJA E DYTË

*Vend pune. Disa vullnetarë punojnë më në thellësi, rrabin trasenë me tokmak. Në plan të parrë punojnë me karroca dore të tre shokët. Edhe Drita është sipër, punon.*

VASOJA: — (*Duke kaluar me karrocën e mbushur*) Katermbëdhjetë! (*Del.*)

KOÇOJA: — (*Duke kaluar*) Njëmbëdhjetë!

LAZJA: — Po ashtu. Tetëmbëdhjetë! (*Takon Vason në kthim.*)

VASOJA: — Shtatëmbëdhjetë, mos na bëj qorra, Laze!  
Le që atje ku shkarkojmë dheun i mbajnë shënim.  
Nuk gënjen dot as ti, as unë.

LAZJA: — Me mua nuk matesh dot ti, jo!

KOÇOJA: — Ore, Laze, kam dëgjuar se, kush shet mendje këtu, e marrin zët. Ta them pa shaka...

VASOJA: — Po i heq fare këto opingat, se më pengojnë (*I le në qoshe.*)

KOÇOJA: — Komandante Drita po vjen këtej, Vaso!

VASOJA: — Le të vijë. Ne po punojmë, nuk po rrimë në hije.

LAZJA: — Dje sikur punuam më shumë.

KOÇOJA: — Ashtu të duket, se puna s'ka mbaruar (*Vaso*) Shikoni, unë them që Lazja të sheshojë atë grumbull dheu atje, unë të mbush karrocat, ti, Vaso, të shkarkosh tutje. Si thoni?

LAZJA: — Jo, jo, se kështu ecim si breshka. Secili ta mbushë vetë karrocën dhe ta shpjerë tutje. Në sulm! (*Del me karrocë. Hyn Drita*).

DRITA: — (*Vasos, pasi i hedh një sy grumbullit të dheut*) Mirë keni punuar. Çdo ditë po përparoni.

VASOJA: — Ne nuk po e plotësojmë ende normën. Të tjerët bëjnë nga dy a tri.

KOÇOJA: — Pse, ore, me fuqinë e Pandit do të matemi ne?

LAZJA: — A, lëre ti, se nuk matesh dot as me mua.

KOÇOJA: — Prapë po shet mendje ti, Laze?

DRITA: — Mjaft tani. Po grindeni? Këtu jemi të gjithë shokë dhe punojmë me të gjitha forcat. Ne nga ju për moshën që keni, jemi të kënaqur.

VASOJA: — Edhe në mensë kemi punuar, edhe këtu po punojmë.

LAZJA: — Ku të na thonë, ku të jetë nevoja. E kemi për nder që punojmë.

DRITA: — Meqë ra fjala, cili nga ju ka qejf të bëhet mësues?

VASOJA: — Mësues nga ne? (*Vë buzën në gaz*).

KOÇOJA: — Po ne jemi nxënës vetë.

LAZJA: — Çfarë mësuesi? Në cilën shkollë?

DRITA: — Këtu, në hekurudhë. Na duhet një shok sa për t'u mësuar shkrim e këndim disa vullnetarëve.

VASOJA: — Aha... e mora vesh. Për kursin kundër analafabetizmit, apo jo?

DRITA: — Po nuk është aq e lehtë... Kursantët janë të moshuar, por kanë qejf të mësojnë. Si thua, Vaso, a pranon?

VASOJA: — Ku ta di unë si të them? Ndoshta nuk ia dal dot.

LAZJA: — Provoje, Vaso! Se mos do të të përjashtojnë nga hekurudha...

DRITA: — Mos e merr me frikë. Do të të ndihmoj edhe unë. Fletoret i kemi siguruar. Lapsat po ashtu. Të flas me shokët e shtabit?

KOÇOJA: — Nuk do të punojë më me ne Vasoja?

DRITA: — Do të punojë. Kursin do ta vazhdojë në orët e lira, pasdite. Të pëlqen!

VASOJA: — Mirë... Vetëm të pyes edhe vëllanë.

DRITA: — Me Pandin flas unë. Ai nuk kundërshton.

LAZJA: — Ta merrte mendja, Vaso, se do të bëheshe mësues në hekurudhë?

DRITA: — Kurse ti, Laze, dhe ti, Koço, do të merrni pjesë në grupin e teatrit ose në kor. Mirë?

KOÇOJA: — Si urdhëroni!

VASOJA: — Kur do të bëhem mësues? Më fal, desha të them, kur do fillojë kursi?

DRITA: — Që nesër janë gati. Ty të presin.

LAZJA: — Po unë me Koçon, kur do të shkojmë?

DRITA: — Edhe ju që nesër. Atje do të gjeni plot shokë dhe shoqe vullnetarë (*Dëgjohet zëri i kuzhinier Lipes*).

LIPJA: — Hajde pas meje, hajde! Ja ku është shoqja Drita.

DRITA: — Si është puna, Lipe? Prapë po grindesh?

LIPJA: — (*Tërheq nga cepi i xhaketës Shyqyriun dhe e fut në skenë*) E shikon këtë? E shikoj, thuaj. Më hëngri shpirtin... A ma prutë sot në mensë që të punojë aty?

DRITA: — Nuk bëri gjë?

LIPJA: — Nuk e tundi fare këmbën. Oj, ky! Më rri këtu si i damllosur!

SHYQYRIU: — Jo, ore!

LIPJA: — Hëngri një kusi naa... me makarona, piu dhe një gjym me ujë dhe vajti e u shtri te plepat... Më ranë këmbët duke e kërkuar. Kur ja, e gjej të shtri-

rë si buall duke gérhitur. Dëgjon, shoqja Drita,  
dëgjoj, thuaj... Unë s'e mbaj më.

SHYQYRIU: — Jo, ore!

LIPJA: — Këtë fjalë di vetëm ky (*Imiton*) «Jo, ore!»  
Vullnetar i thua vetes ti? Dembel!

SHYQYRIU: — Jo, ore! Mua më hanë duart pér punë...

LIPJA: — Or, ty të hanë brinjët, po ç'të bëj që s'lejohet,  
pa ta ndreqja mirë samarin!

DRITA: — Dëgjo, Shyqyri...

LIPJA: — (*E ndërprejt*) Dëgjova, thuaj...

SHYQYRIU: — Më thonë Shyqo...

DRITA: — Mirë, e gëzofsh! Të kemi dhënë lopatën; na  
thua se s'ke fuqi, puna me kazmë nuk të pëlqen,  
puna me vare është e rëndë, karrocën nuk e shtyn  
dot, se këput mish, në mensë s'ke bërë asgjë...

LIPJA: — Pér ideal, asgjë!

DRITA: — Përse ke ardhur këtu, të tundësh zinxhirin?

LIPJA: — Po, po, zinxhirin...

SHYQYRIU: — Ju më keni të gjithë inat... E di unë!  
(*Do të iki*).

DRITA: — Dale, qëndro aty. Ta dish se do të të nxje-  
rrim përpara brigadës po vijove kështu. Nuk ta ka  
njeri borxh këtë sjellje Shyqyri.

SHYQYRIU: — Më thonë Shyqo.

DRITA: — (*Tregon pionierët*) I shikon këta? As sa ce-  
reku i këtyre s'punon ti.

SHYQYRIU: — Jo, ore!

LIPJA: — Po, ore! Or, po ke hak ti, se po ha qyl këtu!  
Është kjo (*tregon Dritën*), pa të isha unë koman-  
dant, të mbërtheja nga zverku dhe të degdisja në  
djall... more vesh, mora, thuaj.

DRITA: — Do të këmbesh udhë?

SHYQYRIU: — Po! (*Tregon Lipen*) Veç me këtë nuk  
punoj dot.

LIPJA: — Të jetë për mua, unë nuk të qas as në derë të mensës, po ç'të bëj që më urdhëruan të të marr. Se nuk e di unë ç'mall je! (*Dritës*) Të lutem, mos ma dërgo më, se do t'i hedh një kazan me ujë në kokë... (*Del*).

SHYQYRIU: — Do të punoj me këta spurdhjakët, në mos...

VASOJA: — Mbaj gojën, pse na shan?

LAZJA: — Dembelët as ne nuk i pranojmë.

KOÇOJA: — Na lë pa punë ti. Na ngjit sëmundjen tënde...

SHYQYRIU: — Jo, ore! (*Bën ta kapë, Koçoja i shpëton nga duart*). Spurdhjak!

DRITA: — Mbylle gojën, Shyqyri. Hajde me mua.

SHYQYRIU: — Ku të vemi?

DRITA: — Në shtabin e hekurudhës. Le të vendosin shokët. Unë u lodha me ty. Kam edhe punë të tjera... Hajde, de!

VASOJA: — Zbato urdhrin, xha Shyqo! (*Qeshin*).

KOÇOJA: — Mos do një bastun të mbështetesh, plakush?

LAZJA: — (*Pasi ka dalë Shyqyriu*) Çudi, edhe këtu në hekurudhë të ketë dembela??!

KOÇOJA: — (*Vasos*) Është shumë e mirë kjo Drita. Na do fort.

VASOJA: — Edhe e zonja në punë. Pse, kot e kanë bërë komandante brigade?

LAZJA: — Të kish qenë burrë, do të ishte më mirë.

VASOJA: — Pse?

LAZJA: — Po... po ja, ngaqë burrit i shkon fjala më shumë...

KOÇOJA: — Ama, ç'na the dhe ti, o Laze! Ja, ore, burrë është edhe Shyqoja, po nuk bën pesë para.

LAZJA: — Lëre atë. Ai është me vulë në ballë.

VASOJA: — E dini c'mendoj? Ty, Koço, të vjen ndoresh

BIBLIOTEKA E SHTETIT

GUARASTER

INV.

1925

mirë pér vizatim. Vizatoje Shyqon me kusinë e makaronave pérpara...

LAZJA: — Mirë thotë Vasoja. Ia japim pastaj komandantes që ta vëri te ajo tabela para mensës.

VASOJA: — Bëje pas punës. Vazhdojmë, se mbetëm me fjalë (*Vazhdojnë punën. Hyn Sabotatori I*).

SABOTATORI I: — (*Pasi qëndron pak*) Po juve, mor kalamaj, kush ju ka sjellë këtu?

VASOJA: — (*Ndalon karrocën*) Ty ç'të duhet? Shiko punën tënde!

SABOT: I: — (*I nxehur*) Shkoni, ore, në shtëpi, kullosni lopët e fshatit. U bëtë ju të dilni vullnetarë! Më e gjatë lopata se ju... (*Qesh*).

LAZJA: — Shoko, nuk qenke në rregull ti, më duket!

KOÇOJA: — Ç'ke ti me ne? Ti pyetesh këtu?

SABOT. I: — (*Me ton të zbutur*) Unë ju flas si më i madh, se më vjen keq të lodheni e të dërrmoheni që në këtë moshë.

VASOJA: — Mos na e qaj hallin. Ne erdhëm vetë vullnetarë dhe do të qëndrojmë në fund, gjersa t'i hipim trenit.

SABOT. I: — Mirë... bëni si të doni. Edhe unë kam fëmijë. Ju fola si baba!

LAZJA: — Babai nuk më flet kështu si ti. Vetë më la.

SABOT: I: — Bukur, bukur... (*Hyn Sabotatori II*).

SABOT. II: — Ku më humbe? Të kërkova në oficinë. Shpejt, se kemi punë. Ç'rri e merresh me këta qyravecë?

VASOJA: — (*Shokëve*) Këta më duket se janë të dy njësoj, asnjëri s'qenka në të...

SABOT. II: — Mos na çani kokën ju! Më mirë shkoni e lozni cingla. (*Dalin*).

LAZJA: — Po këta të dy! Sikur ka gjetur tenxherja kapakun!

KOÇOJA: — Unë për herë të parë ua shikoj bojën...  
VASOJA: — (*I menduar*) Vetëm për të sharë të tjerët e kishin mendjen... Vetëm kulaku Sheme do të fliste ashtu...

LAZJA: — Mos ia mbyt kot, Vaso! Pse kemi ne vullnetarë të atillë?

KOÇOJA: — Mos ishin të huaj?

LAZJA: — Mundet! Nga ata që vijnë si teknikë... gjoja për të na ndihmuar. Edhe në Elbasan kam parë një të tillë. Ka një mjekër të hollë... të hollë, si sqap!

KOÇOJA: — (*Vasos*) Pse mendohesh? Për fjalët që thanë ata? Nuk më bëhet vonë fare. Mos u mërzit...

VASOJA: — Nuk mërzitem, po them t'ia tregojmë komandantes sjelljen e tyre të poshtër.

KOÇOJA: — Ia themi edhe Pandit.

VASOJA: — Atij nuk bën, pasi është nevrik dhe, ku ta dish, mbasë i kap dhe i shqep në dru. (*Dëgjohet një plasje e fortë. Fëmijët stepen*).

LAZJA: — Ç'plasi kështu? (*Vullnetarët që punonin më në thellësi nga pionierët, dalin me nxitim*).

KOÇOJA: — Kjo ishte bombë!

VASOJA: — Jo, minë! Pa shikoni? Atje u mblodhën shumë vullnetarë. Po shkoj edhe unë të marr vesh. (*Bën të ikë, po Lazja e ndalon*).

LAZJA: — Mos shko, Vaso!

VASOJA: — Pse?

LAZJA: — Komandantja mund të të bërtasë. Pse të largohesh nga puna pa leje? Ja, ajo po vjen me vrap nga ne.

KOÇOJA: — Do të na qetësojë. Kujton se jemi trembur, a ku ta dish.

VASOJA: — Ç'do të ketë ndodhur? Tunele nuk hapen

më. Hekurudha është duke u mbaruar. Këto m'i ka thënë vetë Pandi.

KOÇOJA: — Mos ka ndodhur ndonjë gjë me ata të dy që na folën neve?

LAZJA: — Pse, ua mban atyre të hedhin bomba? I zhdukim me gjithë lecka (*Hyn Drita*).

DRITA: — Këtu jeni?

VASOJA: — Këtu.

DRITA: — Kujtova se ishit larguar. Erdha me vrap.

VASOJA: — Shoqja komandante, ç'ndodhi atje?

DRITA: — Asgjë, asgjë. Tani lëreni punën edhe ju.

LAZJA: — Pse?

DRITA: — Se do të grumbullohen të gjithë vullnetarët aty përpara mensës. Do të flasë shoku Fatmir, komandanti i hekurudhës.

KOÇOJA: — Të tre të vijmë?

DRITA: — Po, po.

VASOJA: — (*I lutet*) Ti nuk do të na tregosh... kushe-di se ç'ka ndodhur...

DRITA: — (*I përkëdhet flokët*) Hekurudha do të mbarojë shpejt, Vaso. Këto gjëra ne nuk na trembin... Jemi mësuar. Ju duhet ta dini se këtu, në hekurudhë, edhe punojmë, edhe luftojmë...

KOÇOJA: — Luftojmë? Po s'ka më luftë! Me cilët luf-tojmë ne?

DRITA: — (*Buzagaz*) Ne po ndërtojmë vendin tonë, po e bëjmë çdo ditë më të bukur... më të lulëzuar. Armiqtë tanë kjo i tërbon... pëlcasin nga inati, bëjnë çmos...

LAZJA: — Le të pëlcasin kur të duan, nuk i ndalon njeri.

DRITA: — Ata na kanë halë në sy. Ata nuk duan që një vend i vogël si Shqipëria të shkojë përpara... Ata duan që vendi ynë të thyhet, të shkojë pas qerres

së tyre... S'lënë gjë pa bërë kundër nesh dhe do të vazhdojnë të bëjnë. Përdorin lloj-lloj mënyrash që të na thyejnë. Më kuptoni? Dhe do vazhdojnë kështu gjersa të thyejnë kokat e tyre.

VASOJA: — Po, po, për të thyer i kanë...

DRITA: — Prandaj themi që lufta nuk ka mbaruar, siç pandehin disa. Gjersa kemi armiq rrëth e rrrotull, që luftojnë kundër nesh, ne i mbajmë sytë hapur dhe mbrojmë fitoret tonë.

LAZJA: — Edhe babai im thotë dendur: «Uji fle, po hasmi nuk fle».

DRITA: — Prandaj, edhe ju që jeni pionierë, hapni sytë, njësoj si ne të rriturit. Shkojmë tanë.

VASOJA: — Shoqja komandante, edhe ne na folën keq sot nga dy veta... Nuk na pëlqyen fare.

LAZJA: — Ashtu si ata nuk flasin kurrë vullnetarët tanë.

DRITA: — Kush ishin?

KOÇOJA: — Emrat nuk ua dimë, po i mbajmë mend si fytyra.

DRITA: — Kur ju folën, çfarë ju thanë?

VASOJA: — Na shanë (*Shokëve*) Merrni veglat dhe karrrocat (*Lazja me Koçon veprojnë*) E di si është puna, shoqja komandante?... Ata të dy kishin inat që edhe ne të vegjlit kemi ardhur këtu për të punuar (*Dalin*).

### Tabloja e tretë

*Dekori i tablosë së parë. Pionierët pastrojnë me fshehë vendin ku do të zhvillohet kursi kundër analfabetizimit. Aty afër është edhe një dërrasë e zezë me dy këmbalecë. Afrojnë stolat.*

LAZJA: — Më shpejt, se mos vijnë kursantët.

VASOJA: — Fletoret dhe lapsat kush i ka?

KOÇOJA: — I mbajti komendantja. Do të vijë vetë, tha.

VASOJA: — Kot e mora përsipër këtë punë. Të ishin fëmijë të klasës së parë, hajde de.

LAZJA: — Ke frikë se mos nuk mësojnë, Vaso?

KOÇOJA: — Unë e di se ç'halle ka Vasoja.

VASOJA: — Çfarë?

KOÇOJA: — Ke hall se mos nuk të binden, mos nuk ta varin.

LAZJA: — Për atë mos u bën merak... Ka disiplinë këtu! Le të jenë burra. Kush i lë ata të bëjnë rrëmujë e të sillen si të duan!

VASOJA: — Jo, s'e kam pér atë. Vullnetarët tanë janë të mirë, të disiplinuar.

KOÇOJA: — Kush të prishë qetësinë ose të mos mësojë, mbaje shënim dhe ia ço komandës së shtabit. Ka komandë këtu, or babam! (*Dëgjohen thirrje: «Urra, urra!»*).

LAZJA: — Pse bërtasin, se fillon kursi?

VASOJA: — Mos ia mbyt kot, Laze. Nuk e sheh si hidhen përpjetë? Kanë marrë flamurin.

KOÇOJA: — More, çudi kam parë këtu... Kur jepet flamuri, bëhet sikur është dasmë e madhe.

LAZJA: — Edhe mua më ka rënë në sy. Kur janë prapa me flamurin, çohen punojnë edhe natën... varda, varda...

VASOJA: — Pardje nja dy vullnetarë po ziheshin me një teknik.

KOÇOJA: — Me grushte?

VASOJA: — Jo, or, jo! Haheshin me fjalë se gjoja nuk ua kish matur mirë punën. E kishin hallin te flamuri.

LAZJA: — Më mirë të kishin nga një flamur të gjithë dhe të mos ziheshin kështu!

VASOJA: — Nuk është puna as te flamuri dhe as te të zënati.

KOÇOJA: — Po ku?

VASOJA: — Në atë që secili do të punojë më shumë dhe më mirë. Ma ka thënë vetë shoqja Drita. Dje në luftë, tregon ajo, partizanët bëheshin copë kush e kush të luftonte më shumë. Ndërsa tani, po kjo përpjekje.

LAZJA: — Hajde, ore, ç'njerëz! Të mrekullueshëm...

VASOJA: — Edhe ne ashtu do bëhem, Laze!

KOÇOJA: — Pse kot erdhëm këtu ne? (*Hyjnë disa vullnetarë me Dritën.*)

DRITA: — Hajdeni, shokë, uluni. Zini nga një vend.

VULLNETARËT: — Për hajër na qoftë!

— U bëmë si çiliminjtë!

— Kush është mësuesi!

— Do të fillojmë?

— Po këta pionierët, pse kanë ardhur?

DRITA: — Mbani qetësi (*Merr Vason për krahu*) Ky

djali éshtë ai që do t'ju mësojë shkrim e këndim  
(*Zhurmë, habi, të qeshura*).

ZËRA: — Ama, burrë qenka!

- U bë veza të mësojë pulën!
- Pushoni, bre, nuk ju pëlqen?
- I vogël, po ka shkollë ai. Ne jemi pykë në diell!
- Fillojmë, fillojmë!

DRITA: — Ju lutem, pa zhurmë. Vasoja dhe këta dy të tjerët janë pionierë shumë të mirë dhe të sjellshëm. Keni për të parë se sa bukur dhe sa shpejt do të mësoni (*U jep Lazes dhe Koços fletoret dhe lapsat*) Ua ndani me radhë. Nga një fletore dhe gjysmë lapsi secilit. Të mbani rregull, të kini mendjen dhe t'i bindeni drejtuesit të kursit. Epo, shokë, suksese! (*Vasos*) Punë të mbarë, Vaso! (*Del.*).

LAZJA: — I ndamë të gjitha... (*i bën me kokë: fillo*).

VASOJA: — (*I hutuar dhe me turp.*) Ne... sot, të dashuri fëmijë... (*Të qeshura. Lazja kafshon buzën, Koçoja kruan qafën*)... desha të them, shokë vullnetarë, do të mësojmë alfabetin tonë. Gjuha shqipe ka tri-dhjetë e gjashtë germa... (*Një vërvshëllimë*).

ZËRA: — Paska shumë, qamet!

- Pushoni, ore burra.
- Të gjitha sot do t'i mësojmë?
- Hajde, kokë, hajde!
- Po ti, ore, qysh i paske mësuar gjithë ato?

VASOJA: — Do t'i mësojmë bashkë, një nga një. Mos u mërzitni! Kur isha në klasë të parë, edhe mua më dukeshin shumë.

KOÇOJA: — E dini sa kollaj mësohen?

LAZJA: — Keni për ta parë. Vazhdo, Vaso!

VASOJA: — Në fillim vjen germa A. Ja ta shkruat në dërrasë të zezë që ta shihni (*Nxjerr nga xhepi një shkumës dhe shkruan A*) Kjo éshtë germa A. Ja,

po e bëj prapë (*Shkruan*) Tani do ta shkruani edhe ju në fletore.

KOÇOJA: — Filloni, se do t'ju ndihmojmë edhe ne (*Kalojnë herë te njëri e herë te tjetri*).

VASOJA: — A-ja bëhet kollaj. Dy sfurka të vogla për së gjati dhe një për së gjëri (*Ua tregon*) Ja... (*Hyn Shyqyriu si i xhindosur me një fletë në dorë*).

SHYQYRIU: — (*Duke tundur fletën*) Kush është ai spurdhjak që e bëri këtë? Ku është? Shpirtin do i marr (*Vasos*) Ti e bëre këtë?

VASOJA: — Mos na e prish mësimin, merr vesh? Shko sqarohu në shtab. Ata i dinë këto punë (*Shyqyriu bën ta kapë, Lazja i shkon në ndihmë Vasos*).

LAZJA: — (*Shyqyriut*) Ku je, u marrose? (*Vullnetarët ngrihen dhe e mbërthejnë Shyqon*) Pse e nget, ç'të bëri?

SHYQYRIU: — (*Tregon fletën*) Ja, më ka bërë si birin e dreqit!

— Ti je ca më keq.

— Paska luajtur nga vidat...

— Sa bukur e paska lyrosur!

SHYQYRIU: — Ky nuk më ka lyrosur, më ka katranosur.

NJË VULLNETAR: — Po ti ç'je, nuk je katran me bojë? (*Të qeshura*).

SHYQYRIU: — (*Tregon karikaturën*) E shikoni? Është e drejtë? Më ka vizatuar si gogozhel. Le pastaj ç'ka shkruar këtu poshtë... (*Lexon me pahir*) «Shyqoja bluan si një ka, sa për punë, mos e nga!» (*Qeshin të gjithë*).

ZËRA: — Mirë ta ka bërë!

— Po zë ndryshk...

— I lumtë pionierit!

— Të të bëjë edhe një tjeter...

— Ty vetëm stomaku të punon...

SHYQYRIU: — Jo, ore, pse fare nuk punoj unë?

KOÇOJA: — Vetëm kur fle. Ta tha edhe shoqja Drita!

SHYQYRIU: — Mbylle gojën ti, lepur. Pse e bëre këtë, ë?

KOÇOJA: — Desha që e bëra, hë, ke inat? Hë, ç'do të bësh, o Shyqyri?

SHYQYRIU: — Më thonë, Shyqo mua!

VULLNETARËT: — Pa preke me dorë!

— Ik, se na prishe mësimin (*Në këtë kohë hyn Fatmiri*).

FATMIRI: — (*Shyqos*) Ty po të kërkoj. Përse e hoqe karikaturën nga tabela? Bjere!

SHYQYRIU: — (*Ia jep*) Urdhëro.

FATMIRI: — Do të vish ta vendosësh vetë, me duart e tua. Kush të tha ta hiqje? Kujt i more leje? Ku jemi këtu?

SHYQYRIU: — Vetë e hoqa. Të tallet një spurdhjak me mua?

ZËRA: — Dembelët s'kanë vend këtu.

— Të dalë përpara brigadës.

— Fshesën!

FATMIRI: — Ju zotove shokëve të shtabit se do të bëje kthesë. Pa na thuaj, çfarë bëre sot?

ZËRA: — E bëri kthesën dhe u fut në kuzhinë (*Të qeshura*).

— Sa kusi me fasule gérreve, Shyqooo?

FATMIRI: — Do t'ia vësh gishtin kokës ti, apo jo?

SHYQYRIU: — Si urdhëron. Po këtë? (*Tregon karikaturën*) Mos e vini atje.

FATMIRI: — Kur të punosh e të sillesh si gjithë vullnetarët, ne do ta heqim dhe do të të lavdërojmë, ndryshe do të largohesh me turp nga hekurudha. Eja me mua tani (*Dalin*).

VASOJA: — Na prishi edhe mësimin (*Vullnetarët zënë përsëri vendet*).

NJË VULLNETAR: — Na çoroditi, sa harruam edhe a-në...

VASOJA: — E mësojmë prapë (*Në tabelë*) Pra, kjo është germa A. E shkruat të gjithë? Shkruajeni sa më shumë.

ZËRA: — E bëmë!

- Unë nuk e qullos mirë.
- Do ta mësosh, o shok!
- Vazhdojmë.
- Me leje, o shoku pionier?

VASOJA: — Urdhëroni!

VULLNETARI: — E pse e mësojmë kështu nga A-ja kë-të allfavitën ne?

VASOJA: — Po si ta mësojmë?

VULLNETARI: — Po ja, unë dua të mësoj njëherë se qysh të shkruaj fjalët Parti dhe Enver, pa pastaj mësojmë ç'të duash.

VASOJA: — Po ne kështu e kemi mësuar në shkollë, sipas alfabetit.

VULLNETARI: — Or, po lëre si e ke mësuar ti në shkollë! Unë dua ta mësoj siç më hyn mua në punë. Këtu nuk jemi në shkollë, po në hekurudhë. Të mësojmë si shkruhet fjala hekurudhë, pastaj fjala trenë e pastaj, po deshe, më kthe te A-ja, a ku të duash.

VASOJA: — Edhe kështu mund të bëhet.

ZËRA: — Ashtu, ashtu bëje!

VASOJA: — Ja si shkruhet emri «ENVER» (*E shkruan në dërrasë*) Tani le t'i marrim gërmat një nga një. Kjo është E-ja.

KOÇOJA: — Po vjen komandantja për të na parë (*Hyn Drita*).

DRITA: — Mirë vete puna?

ZËRA: — Mirë. Bukuri...

— E duam mësuesin.

— Është djali ynë!

DRITA: — (*Pasi shikon shkrimet në dërrasë të zezë*)  
E paske filluar ndryshe alfabetin. Shumë mirë, va-  
zhdoni.

VASOJA: — Këta e deshën vetë kështu. Pastaj me radhë  
do u bëj edhe gërmat e tjera.

DRITA: — Mirë, shumë mirë! Ti, Koço, dhe ti, Laze,  
shkoni të dy te ajo baraka, e shikoni? Ajo përtej, e  
lyer me bojë kafe. Aty tani po mblidhen ata të ko-  
rit dhe të teatrit. Kërkon Piron. Na dërgoi Drita,  
i thoni. Me vrap, pionierë! (*Ata dalin*) Ju, shokë  
vullnetarë, bëni ca pushim, po mos u largoni, se  
do të vazhdojmë orën e dytë.

VASOJA: — Si thua, shoqja komandante, do t'i mësoj  
dot kursantët? Ke besim?

DRITA: — (*I përkëdhel flokët*) Kam shumë besim, Va-  
so! S'ka punë që t'i vihet njeriu dhe mos ta bëjë.

VASOJA: — Sa mirë e thatë, shoqja Drita.

DRITA: — A e di se kush ka ardhur të të shohë?

VASOJA: — (*Ngre supet*) Jo.

DRITA: — Babai!

VASOJA: — (*Tepër i gëzuar*) Babai?! Ku është? Më ka  
marrë malli. Dua ta takoj (*Hyn Nikoja me Pandin.*  
*Vasoja hutohet*).

NIKOJA: — Babai, babai, po ti ia mbathe pa lejen e ba-  
bait, ama! (*E përqafon*).

VASOJA: — Edhe ti kështu dole partizan. Vetë më ke  
thënë. Pse jo, Pandi?

DRITA: — (*Vasos*) Epo, s'kishe kujt t'i ngjaje.

NIKOJA: — E, asokohe luftonim armikun.

VASOJA: — Edhe sot kemi armiq, baba. Ja, pyete komandanten.

NIKOJA: — Kemi, or, kemi, po të na marrin të keqen. Kokën e tyre do të hanë. Le ta provojnë po të duan. Me tek sy flenë të gjithë shqiptarët (*Ndez një duhan*).

PANDI: — Sonte nuk të lëmë të ikësh, baba.

DRITA: — Rrini tok me vullnetarët.

NIKOJA: — Meqë po më mban, do të rri. Nuk kam se si të kthehem sonte në Fier. Po ti, Vaso, ç'do të bësh... a do vish nesër me babanë?

VASOJA: — Aman, baba, lermë. Unë punoj sa mundem, nuk rri kot. Ja, pyete komandanten time.

NIKOJA: — Më thanë që je bërë edhe mësues.

PANDI: — Le të rrrijë, baba. Kthehem bashkë, kur të mbarojë hekurudha.

VASOJA: — T'i thérres kursantët, shoqja komandante?

DRITA: — Po. (*Nikoja, Pandi dhe Drita dalin, ndërsa Vasoja thérret*).

VASOJA: — Shokë vullnetarë, hajdeni! Fillojmë orën e dytë (*Kursantët futen grupe-grupe*).

## TABLOJA E KATËRT

*Po ai dekor. Është mesi i natës. Për një çast skena  
është bosh; pastaj hyn Fatmiri. Ai ndez një cigare  
dhe në dritën e shkrepse shikon orën.*

FATMIRI: — Plot dymbëdhjetë. As Drita dhe as Pandi  
nuk po duken. Mos kanë rënë në gjurmë të tyre?  
Kemi afro një muaj që po i gjurmojmë... dhe, po i  
zumë dot me presh në dorë... (*Hyn Drita*).

DRITA: — Në sektorin e parë, në të dytin dhe në të  
tretin qetësi.

FATMIRI: — Po rojet, a qenë në vendet e tyre?

DRITA: — Po, i kontrollova vetë. Fola me ta (*Pauzë*)  
Pandi nuk është kthyer?

FATMIRI: — Jo. Shumë po na lodhin dhe po na mu-  
ndojnë, maskarenjtë!

DRITA: — Ata përpiken të gjejnë kohën dhe rastin pér  
t'ia arritur qëllimit.

FATMIRI: — Veçse nuk do t'ia arrijnë dot (*Pauzë*).  
Sonte nata është pus. Mund të bjerë edhe shi.

DRITA: — (*Vështron qiellin*) Nuk besoj (*Pauzë*).

FATMIRI: — Atje tutje shoh një hije...

DRITA: — (*Vëren me kujdes*) Është Pandi. E njoh nga  
të ecurit.

FATMIRI: — Po vjen qetë-qetë, kjo do të thotë se s'ka  
asgjë të re.

DRITA: — Kush nga sektorët na mbeti pa kontrolluar sonte?

FATMIRI: — Po... sektori i urës dhe tuneli i parë.

DRITA: — Janë caktuar shokët që do t'i kontrollojnë?

FATMIRI: — Domosdo, i njoftova që në mëngjes (*Hyn Pandi*).

DRITA: — Qetësi?

PANDI: — Në rregull.

FATMIRI: — U lodhe, Pandi?

PANDI: — Pak.

DRITA: — Shko, fli.

FATMIRI: — Mirë thotë, shko. Ti je ngritur para nesh.

PANDI: — Do t'u hedh edhe një sy fjetoreve të vullnetarëve, pastaj mund të mbështetem pak. Po pati gjë, thirrmëni pa vonuar.

FATMIRI: — Unë do të qëndroj, pasi pres përgjigje edhe nga sektorët e tjera.

DRITA: — Po qëndrojmë bashkë, shoku Fatmir.

PANDI: — E ke me vete armën?

FATMIRI: — E kam.

PANDI: — Unë po shkoj.

FATMIRI: — Po të përcjellim pak, Pandi. (*Dalin. As gjë nuk dëgjohet, veç zogut të natës. Pas pak hyjnë njëri pas tjetrit Vasoja, Koçoja dhe Lazja*).

LAZJA: — Kot u ngritëm të punojmë natën.

KOÇOJA: — Pse kot?

LAZJA: — Na shikon ndonjë, vete i tregon komandantes dhe na bën leckë pastaj.

VASOJA: — Mos thërrisni. Nata e parë është kjo... Ta provojmë edhe ne. Nuk do të ngrihemë më.

KOÇOJA: — Veglat ku janë?

VASOJA: — I kam fshehur unë. Një karro, një kazmë dhe një lopatë.

LAZJA: — Nuk po më hapen fare sytë (*Hap gojën.*)  
Ç'më gjeti!

VASOJA: — E di ç'do të bëjmë? Shkojmë dhe lahemë  
në çesmë. Të del menjëherë gjumi.

LAZJA: — Uuu, ç'kam bërë! Paskam dalë zbatbur!

VASOJA: — Shko mërr shpejt opingat, se është natë.  
Të ngulet ndonjë gjë në këmbë. Nisu, se këtu të  
presim.

LAZJA: — Ika! (*Largo het*).

VASOJA: — Të ka marrë malli për njerëzit e shtëpisë,  
Koço?

KOÇOJA: — Shumë, për të gjithë... Edhe për fshatin...  
edhe për shokët. Edhe për mësuesit... Më duket si-  
kur kam shumë kohë pa i takuar.

VASOJA: — (*Psherëtin*) Edhe mua. Pas një muaji hapen  
shkollat. Ti për ku e hodhe lutjen?

KOÇOJA: — Të kam thënë. Në Liceun Artistik, për  
pikturë.

VASOJA: — Mua më pëlqen të bëhem mësues.

KOÇOJA: — Të mësosh analfabetët?

VASOJA: — Në vendin tonë nuk do të ketë analfabetë.  
Këta që kanë mbetur, janë nga të, fundit. Më tha  
vetë komandantja.

KOÇOJA: — Sa e mirë është ajo!

VASOJA: — Këtu të gjithë të mirë janë!

KOÇOJA: — Të gjithë, jo xhanëm. Ja, merr Shyqon.

VASOJA: — E pse të marrim Shyqon? Ai një është. Po  
a e beson ti se edhe ai ka ca ditë që arrin normën?  
Më tha vetë shoqja Drita.

KOÇOJA: — Pse s'thua! Qenka tundur edhe Shyqoja!

VASOJA: — Këtu, Koço, është edhe hekurudhë, edhe  
shkollë. Analfabetët mësojnë shkrim e këndim,  
dembelët shkunden e bëhen njerëz. Ne po mëso-  
hemi të punojmë si të mëdhenjtë...

KOÇOJA: — Jo më kot mësuesi na e lëvdonte aq shumë hekurudhën. (*Hyn Lazja me një frymë*).

LAZJA: — Koço, Vaso!

VASOJA: — Ç'ke?

LAZJA: — (*Mezi merr frymë*) Pas atij kanalit të madh pashë...

KOÇOJA: — Fol, ore, ç'pe?

LAZJA: — Pashë dy veta që ecnin si këmbadoras...

VASOJA: — Pse ecnin ashtu?

LAZJA: — Që t'i shpëtonin dritës ku ishte roja...

KOÇOJA: — Po kush ishin?

LAZJA: — Se mos i njoha unë?

VASOJA: — Po nga ia mbajtën?

LAZJA: — Për këtej e morën drejtimin... Si t'ia bëjmë?

KOÇOJA: — Duhet të japim alarmin.

VASOJA: — Jo, nuk bën. Këto punë duhen marrë ngadalë, në qetësi. Unë po vete të zgjoj Pandin.

KOÇOJA: — Po ne, vetëm të rrimë?

VASOJA: — Ju fshihuni dhe shikoni nga do të kalojnë (*Vrapon*).

LAZJA: — (*I merr dorën dhe e vë në zemër*.) Dëgjon se si më rreh?

KOÇOJA: — Mos ke frikë?

LAZJA: — Kush, unë frikë? Mos, more! Unë vetëm mendoj si do t'i kapim.

KOÇOJA: — Kishin gjë vegla në duar?

LAZJA: — Nuk i vura re, më dolën papritur (*Dëgjohen hapa dhe pëshpëritje*).

KOÇOJA: — Dëgjove gjë?

LAZJA: — Jo.

KOÇOJA: — Vër veshin mirë.

LAZJA: — Po... po, ca pëshpëritje... Fshihemi shpejt këtu dhe përgjojmë (*Fshihen pas zyrës së shtabit*).

SABOTATORI I: — (*Duke hyrë*) Ec; nuk duket njeri  
(*Tjetri afrohet*).

SABOTATORI II: — Po kaluam edhe këtu, e hodhëm!

SABOTATORI I: — Sa mban që këtej ura?

SABOTATORI II: — As një çerek ore!

SABOTATORI I: — Që këtu të fillojmë të ecim larg  
njëri-tjetrit.

SABOTATORI II: — Mirë. Takohemi te ura. Kujdes atë...  
Hiqja siguresën pistoletës.

SABOTATORI I: — Mos ki merak (*Ikën*).

SABOTATORI II: — (*Kthen kokën anash, por nuk sheh  
as Koçon, as Lazen*). Eh, na vaftë mbarë! (*Del pas  
shokut*).

LAZJA: — I pe? I njohe kush ishin?

KOÇOJA: — M'u dukën si ata të dy që na shanë atë  
ditë...

LAZJA: — Vasoja pse s'po vjen?

KOÇOJA: — Hë de, Laze!

LAZJA: — Ç'do?

KOÇOJA: — More vesh ti se ç'duan të bëjnë ata të dy  
te ura?

LAZJA — Ku ta di unë i ziu? Po për punë të mirë nuk  
e besoj të venë natën, fshehurazi. Pastaj, ajo pis-  
toleta... siguresa...

KOÇOJA: — Kështu them edhe unë.

LAZJA: — Kishin edhe një si kuti në dorë, i pe?

KOÇOJA: — Të vete të shikoj për Vason?

LAZJA: — Jo, jo, ne duhet të lajmërojmë shpejt Pandin  
(*Sa bëjnë të dalin, në çast hyjnë Pandi, Fatmiri,  
Drita, Vasoja*).

VASOJA: — (*Të dyve*) Ku janë?

KOÇOJA: — Kaluan këtej.

FATMIRI: — Kur?

LAZJA: — S'ka pak. Ishin dy.

KOÇOJA: — Takohemi te ura, thanë!

PANDI: — E qartë (*Dalin me nxitim*).

VASOJA: — Shoqja komandante!

DRITA: — Ç'do, Vaso? S'kam kohë...

VASOJA: — Të vijmë edhe ne?

DRITA: — Jo! Në asnjë mënyrë. Shkon flini (*Del*).

VASOJA: — Si tha, flini? Po a flihet kështu ?

KOÇOJA: — Të flemë ne, kur armiku na lufton?

LAZJA: — Mua tani më doli gjumi fare.

VASOJA: — Aq më mirë.

KOÇOJA: — A do t'i zënë dot?

LAZJA: — S'do mend! I lë Pandi pa i kapur? Bile, unë trembem mos nuk i bie të gjallë, se nuk ta përtón shumë ai (*Dëgjohet një e shtënë dhe pas pak dy të tjera*).

VASOJA: — Po këto armë?

KOÇOJA: — Ndoshta luftojnë, se nuk dorëzohen...

LAZJA: — Nuk kanë ku të futen, jo! I shqyejnë vullnetarët me dhëmbë!

KOÇOJA: — Po sikur të vritet ndonjë nga tanët, nga shokët vullnetarë?

LAZJA: — Kush? Lë Pandi t'i vriten shokët? Po ne, kështu do të rrimë?

KOÇOJA: — Jo, kështu nuk mund të qëndrojmë, po ç'do të bëjmë?

VASOJA: — Të bëjmë tutje! Pse, ore, sehir do të mbajmë?

KOÇOJA: — Po ne nuk kemi armë!

LAZJA: — Hajdeni se edhe pa armë luftohet. Rrëmbejmë nga një hu gardhi.

VASOJA: — Me armë, pa armë, kështu nuk mund të rrimë. Ejani! Do t'u dalim krah shokëve vullnetarë. Ku ta dish, armiqtë mund tëjenë shumë. Mund të ketë edhe të tjerë, veç atyre të dyve që kaluan

këtej. O burra, përpara! (*Dalin me nxitim. Pauzë përnjë çast, pastaj zhurmë dhe të thirrura të vullnetarëve. Pas pak turma hyn brenda.*)

PANDI: — Ecni përpara, kërma! (*Hyn; në dorë ka pistoletën dhe shtyn përpara sabotatorët. Pas tyre hyjnë vullnetarët, që u kërcënohen. Duket edhe kuzhnier Lipja, pas tij vjen Shyqyriu me një hu të madh në duar.*)

VULLNETARËT: — Maskarenj!

— Të shitur!

— Borgjezë!

— Fashistë, ballistë!

— Do t'ju shtypim kokën si gjarprit!

FATMIRI: — (*Vullnetarëve*) Mjaft! (*I tregon diçka Pandit*) Minë me sahat...

DRITA: — Për në ç'orë ishte kurdisur?

FATMIRI: — Më tetë të mëngjesit.

PANDI: — Pikërisht në atë orë do të hidhnin në erë urën bashkë me shokët tanë që punojnë atje.

FATMIRI: — (*Sabotatorëve*) Ku i keni vënë minat e tjera? Flisni!

SABOTATORI I: — Unë s'di gjë... Unë...

SHYQYRIU: — Po nuk folët, ua zhulata kokës këtë hurrin (*Matet, po e ndalon Pandi*).

PANDI: — Flisni!

SABOTATORI I: — Ky, ky i di! (*Tregon tjetrin*).

SABOTATORI II: — Unë do t'jua tregoj të gjitha... Vettëm, amani, mos më vrissni...

PANDI: — Hë, kërmë, kaq shumë t'u dhimbksa kjo lëkurë e ndyrë?

NJË VULLNETAR: — I shitur!

LIPJA: — Pa le, po ju kam dhënë edhe të hani... E paçi harram, e paçi! Ju daltë për hundësh! Morët vesh, morëm, thoni! Ju ngectë në grykë, ju ngrectë.

VASOJA: — (*Shokëve*) Sa inat më vjen!

KOÇOJA: — Përse?

VASOJA: — Si, ore, nuk i kapëm më përpara ne këta?

PANDI: — (*Sabotatorëve*). Nisuni, përpara!

VULLNETARËT: — (*Thërrasin duke dalë*) Armiqtë në litar!

— Plumbin kokës!

— Në litar! Në litar!

DRITA: — (*Pionierëve*) Po ju, përse nuk fjetët?

VASOJA: — Ama edhe ju, komandante, ne na gjetët të vini në gjumë? Përderisa nuk flenë armiqtë, ç'është ai gjumë për ne?

LIPJA: — Mirë thonë pionierët, shoqja Drita... Ta kini syrin dritë dhe gishtin (*tregon për pushkën*) në këmbëz! (*Del*).

DRITA: — Ti, Koço, t'u qëndisësh nesër atyre të shiturve një karikaturë të madhe.

KOÇOJA: — E kam vetë merak atë punë!

VASOJA: — Ti, Laze, pse rri i mërzitur? Ç'ke?

LAZJA: — Mërzitem, se ata të teatrit më kanë dhënë të luaj rolin e një djali ballisti. E di sa turp që më vjen? (*Qeshin*).

KOÇOJA: — Me pahir ia dhanë.

LAZJA: — Po ç'të bëja? As ti nuk e more, Koço, ma latë mua sikur ta kishit bërë me fjälë (*Qeshin*).

DRITA — Atë rol luaje sa më mirë, se nuk të shan kush. Ti je pionieri ynë! Hajdeni tani të flini, ndryshe nuk do keni fuqi për të punuar nesër (*Dalin*).

## TABLOJA E PESTË

*Dekori i tablosë së dytë. Vendpune. Vullnetarë punojnë me sulm. Aty janë edhe të tre pionierët.*

DRITA: — Në sulm, shokë, se jemi pas me normën!

VASOJA: — Për inat të armiqve, përpara! (*Vrapon me karrocën e dorës. (Hyn Fatmiri).*)

FATMIRI: — Shoqja Drita, ku i ke ata trimat tanë të vegjël?

DRITA: — Ja ku janë, në punë, si gjithmonë.

FATMIRI: — Pa ejani këtu, trima! (*Ata vijnë, i përqafon*). Në emër të shtabit të përgjithshëm të heku-rudhës, unë ju përgëzoj pér ndihmën që na dhatë në kapjen e sabotatorëve. Për këtë do të njoftojmë edhe këshillin popullor të fshatit tuaj, si dhe familjet tuaja. Ju lumbë, pionierë. Ta kini gjithmonë syrin pishë. (*Del. Vullnetarët që punojnë aty duartroksin. Të tre pionierët janë të emocionuar.*)

DRITA: — Edhe unë ju falënderoj nga ana ime... (*Hyn Shyqyriu*).

SHYQYRIU: — Besoj se tani edhe unë kam të drejtë t'ju shtrëngoj dorën.

VASOJA: — (*I hutuar*) Po ç'bëmë ne? Si të gjithë vu-llnetarët... (*Emocionohet*).

LAZJA: — (*I emocionuar*) Po, po, si gjithë vullnetarët edhe ne...

KOÇOJA: — (*Nxjerr një fletë*) Ja ç'u kam qëndisur atyre, shoqja Drita!

DRITA: — (*E shikon dhe buzëqesh*). Shumë mirë. Njërit ia paske bërë gjuhën si gjarpër, që vjell mina me sahat, tjetrit ia paske sajuar kokën si sahat mine dhe gojën plot me para... Të lumtë, Koço! Ma lër ta vendos te tabela. T'i shohin të gjithë se ç'fytyra të fëlliçura janë. (*Hyn Pandi tërë gëzim*)

PANDI: — Do t'ju jap një lajm gazmor, shokë! Së shpejti tek ne, në hekurudhë, do të vijë shoku Enver. Prandaj hidhuni në sulm, që ta presim Komandantin me sa më shumë suksese! (*Shpërthejnë urrat e fuqishme. Ngrejnë përpjetë kazma e lopata*) Shoqja Drita...

DRITA: — Urdhëro, Pandi!

PANDI: — Ju kërkojnë në shtab! (*Dalin të gëzuar*).

VASOJA: — (*Shokëve*) E keni parë ju ndonjëherë shokun Enver?

LAZJA: — Unë po. Isha i vogël kur erdhi në Elbasan...

KOÇOJA: — Edhe unë.

VASOJA: — Koço, ku e ke parë ti?

KOÇOJA: — E shikoj çdo ditë, në fotografinë që kemi në klasë, të cilën e kam përballë bankës ku ulem... (*Qeshin*).

LAZJA: — E di ç'mendoj unë? Ne këtu u njohëm, u bëmë shokë dhe vëllezër. Aksione dhe hekurudha do të kemi gjithmonë. Kështu është apo jo?

VASOJA: — Patjetër.

LAZJA: — Ne të japim besën që të vijmë bashkë në çdo aksion, të tre, si thoni?

VASOJA: — Edhe pyet? Unë jam gati! (*I shtrin dorën*).

KOÇOJA: — Edhe unë! (*Vepron si Vasoja*).

LAZJA: — (*Vë dorën e tij sipër tyre*). Gjithmonë të pandarë...

TË TRE: — Udhëve tonë të hekurta... Para marsh... (*Të kapur dorë më dorë, dalin me hap rreshtor*).

## F U N D